



**RAPORT PËRMBLEDHËS  
KORRIK - DHJETOR  
2025**

**Mbi veprimtarinë e**

**Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**

## 1. HYRJE

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktivitetit gjashtëmuor, korrik – dhjetor 2025, të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), duke ofruar një panoramë të punës së kryer dhe rezultateve të arritura në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga VKM nr.737/2017 “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, i ndryshuar, VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, VKM nr. 81, datë 14.2.2023 për miratimin e “Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025” dhe të planeve të veprimit 2023-2025”.

## 2. FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE KOMUNITETEVE PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Gjatë gjashtëmuorit të dytë të vitit 2025, QKEDH ka intensifikuar përpjekjet për zbatimin e angazhimeve të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025, si edhe në Planin e Veprimit për periudhën përkatëse. Aktivitetet kanë qenë të fokusuara kryesisht në forcimin e kapaciteteve institucionale, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, për adresimin e fenomeneve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Një tjetër prioritet ka qenë monitorimi i proceseve të riintegritimit, rehabilitimit dhe risocializimit (RRR), duke siguruar që masat e ndërmarra të jenë efektive dhe të harmonizuara me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Ndërhyrjet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese përfshijnë:**

- **Fuqizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional** në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, duke konsoliduar lidhjet me institucionet ligjzbatuese dhe aktorët e tjerë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm;
- **Fuqizimin e mekanizmave të referimit** për shkëmbimit të informacionit ndërmjet aktorëve institucionalë dhe strukturave të përfshira, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e radikalizmit;
- **Rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike** përmes programeve të trajnimit të dedikuar për identifikimin dhe referimin e shenjave të hershme të radikalizmit;
- **Fuqizimin e kapaciteteve për rehabilitim dhe riintegrim** të personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit, duke siguruar mbështetje të specializuar dhe qasje të koordinuar;
- **Mbështetjen ekonomike të familjeve të prekura**, përmes përfshirjes në programe punësimi dhe kurse kualifikimi, me synim reduktimin e faktorëve të riskut social.

Të gjitha këto ndërhyrje janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore përgjegjëse dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që veprojnë në fushën e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm.

### **Fuqizimi i Komiteteve Rajonale**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 185/2023, QKEDH ka vijuar me fuqizimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar 11 (njëmbëdhjetë) takime të Komiteteve Rajonale në 12 qarqet e vendit, duke siguruar vazhdimësinë e punës dhe koordinimin ndërinstytucional. Paralelisht janë organizuar 9 (nëntë) sesione trajnimi me qëllim rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Sekretariateve të tyre Teknike duke përmirësuar aftësitë për zbatimin e masave parandaluese. Gjithashtu, kanë vazhduar raportimet tremujore drejtuar Koordinatorit Kombëtar për P/KEDH duke garantuar ndjekje të progresit në përputhje me detyrimet ligjore.

### **Trajnimi i punonjësve të strukturave ligjbatuese**

Gjatë kësaj periudhe, QKEDH ka luajtur një rol aktiv në rritjen e kapaciteteve të strukturave të rendit. Në kuadër të këtij angazhimi, janë zhvilluar 8 (tetë) seanca trajnimi dhe janë trajnuar 178 punonjës së Policisë së Shtetit, përfshirë Oficerë të Patrullës së Përgjithshme (OPP), Specialistë të Policisë në Zonë (SPZ) dhe Punonjës të Policisë Kufitare.

Gjithashtu, në kuadër të projektit CIVIPOL për Mbrojtjen e Hapësirave Publike, janë koordinuar 3 trajnime rajonale (një prej të cilëve online) me pjesëmarrjen e 9 drejtuesve dhe oficerëve të lartë të Policisë së Shtetit, së bashku me kolegë nga vende të tjera të Ballkanit Perëndimor.

### **Trajnime për aktorët e vijës së parë**

Gjatë kësaj periudhe, QKEDH ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, duke organizuar shtatë trajnime të dedikuara për aktorët e vijës së parë. Në këto trajnime morën pjesë punonjës të qendrave komunitare, mësues, oficerë sigurie në shkolla, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe punonjës socialë dhe psikologë, me synim rritjen e kapaciteteve për identifikimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Trajnim një ditë me QKEDH / Shërbimi i Provës – Ky trajnim u zhvillua me stafin e Shërbimit të Provës (Dega Territoriale Tiranë) dhe specialistë nga QKEDH, dhe kishte në fokus menaxhimin e rasteve si dhe procesin e referimit në Komitetin Rajonal për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Tiranë.

Janë realizuar trajnime ditore në kuadër të nevojës së identifikuar për të siguruar një trajnim për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) dhe Punonjësit e Njësive të Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVNR) për menaxhimin e rasteve të familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit si dhe punonjës të bashkisë Tiranë.

### **Bashkëpunime me institucionet akademike**

QKEDH në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës ka vijuar me aktivitete duke përfshirë seminare me studentët, si dhe

monitorimi/koordinimi për hartimin e buletinit e parë kërkimor shkencor mbi sigurinë dhe paqen.

### **Edukimi dhe ndërgjegjësimi në komunitet**

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar një sërë trajnimesh mbi të drejtat e njeriut dhe tolerancën fetare, me pjesëmarrjen nxënësve të sistemit parauniversitar dhe të rinjve në qytetet Cërrik, Kavajë, Fier dhe Pogradec. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë rritja e njohurive, aftësive kritike dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për respektimin e diversitetit, promovimin e bashkëjetesës paqësore dhe forcimin e reziliencës ndaj narrativave polarizuese ose diskriminuese.

Gjithashtu janë zhvilluar disa takime informuese dhe diskutime tematike me gra dhe të rinj në disa bashki të vendit, të cilat janë fokusuar në identifikimin dhe kuptimin e shenjave të hershme të radikalizmit, si dhe në nxitjen e angazhimit komunitar për parandalimin e tij. Këto takime kanë synuar forcimin e rolit të komunitetit në raport me sigurinë dhe parandalimin, si dhe ofrimin e mjeteve praktike për të njohur dhe adresuar faktorët që mund të çojnë drejt radikalizimit ose margjinalizimit.

### **Fuqizimi i komuniteteve fetare**

QKEDH në koordinim me Hedayah dhe në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar Shqiptarë kanë organizuar konferencën “Shpërndarje mesazhesh për udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit në Shqipëri” ku dhe u prezantuan katër video mesazhet që do të shpërndahen për ndërgjegjësimin e komunitetit. Në këtë konferencë morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga institucionet qendrore dhe vendore, partnerë ndërkombëtarë, ambasada si dhe aktorë të vijë së parë. Gjithashtu janë zhvilluar 5 (pesë) takime online dhe fizikisht me përfaqësues të Komuniteteve Fetare pjesë e KNFSH-së.

### **Fuqizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike**

QKEDH ka vijuar me një sërë aktiviteteve advokuese dhe trajnimesh për forcimin e rolit të KVSP-ve në bashkitë Kukës, Lezhë, Vlorë dhe Mat, të cilat janë pjesë e Fazës së II-të të projektit “Mbështetja e performancës së Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike në Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm”.

### **QKEDH si Pikë Fokale për Projektin Evropian**

QKEDH, në rolin e saj si pikë fokale për projektin evropian “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga CIVIPOL, ka koordinuar pjesëmarrjen në:

- Seminarin Rajonal “Mbështetje për autoritetet publike në krijimin e rekomandimeve praktike dhe materialeve udhëzuese për: Planet e sigurisë për soft targets; Fushatat e ndërgjegjësimit publik; Programet e ndërgjegjësimit për kërcënimet e brendshme.

- Seminarin Rajonal “Shkëmbimi i praktikave më të mira për: Strategjitë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike; Zhvillimi i strategjive kombëtare të qëndrueshmërisë sipas Direktivës CER; Ushtrime operationale në terren me përfshirjen e sektorit privat (pasja PPP).
- Takimin e 5<sup>-të</sup> të Bordit Drejtues të projektit evropian “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor” zbatuar nga CIVIPOL, mbajtur në Tiranë me përfaqësues nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues të autoriteteve Franceze, Kroate, Italiane dhe Greke.
- Seminarin online i cili trajtoi dy komponentët e projektit, “Rritja e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturës kritike në Ballkanin Perëndimor”, Mbrojtjen e Hapësirave Publike dhe Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, mbi legjislacionin, praktikat e mira dhe mundësitë për partneritete publike dhe private në fushat e mbrojtjes së hapësirave publike dhe infrastrukturave kritike me theks të veçantë qasjen “siguria që në konceptim” (security-by-design).

### **3. PROCESI I REHABILITIMIT/ RIINTEGRIMIT/ RISOCIALIZIMIT PËR PERSONAT E KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT SIRI/IRAK**

QKEDH si institucioni kryesor për zhvillimin e politikave dhe koordinimin në nivel kombëtar, në kuadër të realizimit të iniciativave për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe ndjekjen e proceseve të rehabilitim-riintegrim dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit Siri-Irak, vepron në bazë të VKM (konfidenciale) Nr. 453 datë 29.07 2021 si dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023 – 2025 si më poshtë: Shteti shqiptar ka kryer 4 operacione riatdhesimi, ku ka kthyer 38 (tridhjetë e tetë) shtetas shqiptarë nga zonat e konfliktit Siri-Irak, konkretisht 1(një) shtetas në vitin 2019 (i cili nuk ndiqet nga QKEDH), 13 (trembëdhjetë) shtetas shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27 maj 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetas shqiptarë të riatdhesuar më datën 1 gusht 2021 dhe 5 (pesë) shtetas të riatdhesuar në 27 tetor 2020.

Procesi i rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit (RRR) të shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga zonat e konfliktit përbën një komponent thelbësor së sigurisë kombëtare dhe të politikave shtetërore për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ky proces nuk ka vetëm një dimension social dhe humanitar, por është i lidhur drejtpërdrejt me detyrimet kushtetuese dhe ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe me nevojën për të garantuar stabilitetin dhe kohezionin shoqëror në afat të gjatë. Në këtë kuadër, shteti shqiptar ka zgjedhur një qasje gjithëpërfshirëse dhe parandaluese, duke e konsideruar RRR-në si një instrument strategjik për reduktimin e faktorëve të rrezikut që lidhen me radikalizimin, ri-radikalizimin dhe përjashtimin social. Përmes ndërhyrjeve të koordinuara institucionale, synohet jo vetëm mbështetja e individëve të prekur nga konfliktet e armatosura, por edhe mbrojtja e interesit publik dhe e rendit demokratik.

QKEDH vijon angazhimin maksimal për koordinimin dhe monitorimin e punës me ministrinë e linjës, agjencitë ligj-zbatuese, partnerët kombëtar dhe ndërkombëtarë për të lehtësuar procesin R&R&R në komunitet të 37 (tridhjetë e shtatë) shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga

zonat e konfliktit Siri-Irak, nga të cilët 36 (tridhjetë e gjashtë) të riatdhesuar janë të vendosur në territorin e Bashkisë Tiranë dhe 1 rast në Bashkinë Librazhd.

QKEDH ndjek dhe monitoron procesin e R&R&R në nivel qendror dhe vendor duke u fokusuar në zbatimin e PIM<sup>1</sup> zhvilluar për secilin person nga PMF<sup>2</sup> për fëmijët dhe PS<sup>3</sup> / menaxheri rastit i Njësisë Administrative ku janë vendosur familjet me banim. Në përmbushje të këtij funksioni, QKEDH merr në shqyrtim raportime periodike vlerësuese mbi ecurinë e procesit nga psikologët, teolog të cilat i kemi marrë deri në gusht 2025 (mbështetur nga donatorë ndërkombëtar) dhe zyra vendore arsimore, AKPA<sup>4</sup>. Gjithashtu është pjesë e të gjitha takimeve të GTN ku vlerësohet PIM për secilin rast dhe koordinohet e ndiqet në një linjë me PMF-të.

Aktualisht QKEDH ndjek 37 (tridhjetë e shtatë) PIM-e të cilat rishqyrtohen nga GTN-të, për secilin individ në mënyrë periodike çdo 3 muaj, për të identifikuar nevojat dhe vlerësuar ecurinë në procesin e riintegritimit. Nga grupi i të riatdhesuarave nga zonat e konfliktit të vendosur në territorin e Bashkisë Tiranë, 28 (njëzet e tetë) janë fëmijë nga të cilët, 8 (tetë) individë kanë mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) janë nën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç dhe të gjithë ndiqen me plane individuale si dhe 9 (nëntë) gra të cilat ndiqen nga Shërbimi i Provës. QKEDH-ja ka koordinuar dhe zhvilluar 15 (pesëmbëdhjetë) takime të GTN-ve, të ngritura për të 12 (dymbëdhjetë) familjet e rikthyera nga zonat e konfliktit Siri-Irak ku është diskutuar mbi monitorimin, përmirësimin dhe problematikat që këto raste kanë reflektuar gjatë kësaj periudhe.

Në lidhje me edukimin, 19 (nëntëmbëdhjetë) fëmijë ndjekin arsimin bazë të detyrueshëm 9-vjeçar. Ndërkohë, 8 (tetë) fëmijë kanë mbushur moshën madhore (18+). Prej tyre, 6 (gjashtë) ndjekin arsimin e mesëm në institucione të ndryshme arsimore, si më poshtë: 3 (tre) ndjekin arsimin e mesëm profesional publik, 1 (një) ndjek liceun artistik, 1 (një) ndjek shkollën e mesme sportive “Loro Boriçi” dhe 1 (një) ndjek arsimin e mesëm publik.

Deri në muajin dhjetor 2025, nevojat bazike të familjeve të riatdhesuara nga zonat e konfliktit Siri-Irak janë mbuluar në mënyrë të vazhdueshme përmes mbështetjes së ofruar nga donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë shpërndarjen periodike të kartave ushqimore, mbulimin e kostove të strehimit me qira, si dhe rimbursimin e shërbimeve bazë jetike (energji elektrike dhe ujë). Kjo mbështetje ka pasur karakter të përkohshëm dhe plotësues, në funksion të fazës tranzitore të procesit të rehabilitimit, ri-integritimit dhe risocializimit. Me përfundimin e kësaj mbështetjeje në dhjetor 2025, nga janari 2026 familjet do të përballen me mungesë të plotë të mbulimit financiar për nevojat jetike, duke u ekspozuar ndaj rrezikut real të pasigurisë ekonomike dhe të strehimit.

Në këtë kontekst, është kërkuar një shtyrje e përkohshme e mbulimit të kostove të qirasë për 3 familje, si masë emergjente për parandalimin e humbjes së strehimit, ndërkohë që në total 5

---

<sup>1</sup> Planeve Individuale të Mbrojtjes

<sup>2</sup> Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës

<sup>3</sup> Punonjësi Social

<sup>4</sup> Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë

familje ndodhen aktualisht në strehim me qira. Gjithashtu, është komunikuar në rrugë elektronike me Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për të gjetur një zgjidhje afatgjatë për 4-tër ambiente banimi. Agjencia ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 5087/1 prot., datë 21.10.2025, duke bërë me dije se, nëse do të disponojnë ambiente të përshtatshme, do ti përgjigjen kërkesës sonë. Mungesa e aksesit të këtyre familjeve në skemat shtetërore të ndihmës ekonomike, për shkak të kriterëve ligjore dhe procedurale ekzistuese, e bën të domosdoshëm ndërhyrjen institucionale të shtetit për të garantuar mbrojtjen minimale sociale dhe vijueshmërinë e procesit RRR, në përputhje me detyrimet ligjore dhe strategjike në fushën e mbrojtjes sociale dhe sigurisë kombëtare.

Duke marrë parasysh situatën kritike të familjeve të riatdhesuara nga zonat e konfliktit Siri–Irak, ndërprerjen e plotë të mbështetjes nga donatorët ndërkombëtarë dhe pasojat e drejtpërdrejta në garantimin e nevojave bazë jetike, QKEDH vlerëson të domosdoshme dhe urgjente ndërhyrjen e menjëhershme të institucioneve shtetërore, në përputhje me detyrimet ligjore të shtetit për mbrojtjen e familjeve dhe fëmijëve, si dhe për sigurimin e stabilitetit social dhe të rendit publik.

1. **Sigurimi i zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit** për familjet e riatdhesuara që jetojnë aktualisht në banesa me qira dhe ndodhen në rrezik të humbjes së strehimit, duke përfshirë shqyrtimin dhe ofrimin e banesave sociale, strehimeve alternative të qëndrueshme, ose çdo mekanizëm tjetër të përshtatshëm që garanton mbrojtje të menjëhershme nga rreziku i pastrehësisë.
2. **Përfshirja e të gjitha familjeve të riatdhesuara në skema socio-ekonomike mbështetëse**, me qëllim sigurimin e të ardhurave bazë, ushqimit, veshmbathjes dhe mirëqenies minimale të fëmijëve dhe të rinjve në proces integrimi. Kjo ndërhyrje konsiderohet një domosdoshmëri ligjore dhe institucionale për parandalimin e riskut të ri-margjinalizimit dhe për garantimin e stabilitetit social me mbështetjen e MSHMS-së.
3. **Shqyrtimi dhe krijimi i programeve të posaçme për të rinjtë mbi 18 vjeç**, të cilët nuk përfitojnë më nga mekanizmat mbrojtës për fëmijët, me fokus të veçantë në: punësimin e qëndrueshëm, sigurimin e strehimit, aftësimin profesional dhe mbështetjen psiko-sociale. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar integrimin e plotë të të rinjve në shoqëri dhe për të shmangur rrezikun e përfshirjes së tyre në rrugë të margjinalizimit ose kriminalizimit.

#### **Në mungesë të një reagimi të strukturuar shtetëror:**

- Procesi RRR rrezikon të mbetet formal dhe jo substancial;
- Rritet rreziku i përjashtimit social dhe i margjinalizimit;
- Dobësohet besueshmëria e shtetit përballë partnerëve ndërkombëtarë;
- Cënohen objektivat që kontribuojnë në sigurinë kombëtare.

Suksesi afatgjatë i procesit RRR kërkon një tranzicion të qartë nga mbështetja e bazuar në projekte/donatorë, drejt marrjes së përgjegjësisë së plotë nga institucionet shtetërore.

- Sigurimi i një angazhimi të qëndrueshëm financiar dhe institucional nga ana e institucioneve shtetërore për procesin e rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit të shtetasve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit përbën një detyrim që buron nga parimet

kushtetuese, kuadri ligjor në fuqi dhe strategjitë kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes sociale. Mbështetja e deritanishme e ofruar përmes projekteve të financuara nga donatorë ka pasur karakter plotësues dhe të përkohshëm dhe nuk mund të zëvendësojë përgjegjësinë primare të institucioneve publike për garantimin e shërbimeve bazë, strehimit, mbështetjes psiko-sociale dhe integritit socio-ekonomik të kësaj kategorie.

- Në mungesë të alokimit të fondeve të dedikuara nga buxheti i shtetit, ekziston rreziku që procesi RRR të mbetet i fragmentuar dhe i paqëndrueshëm, duke cenuar objektivat afatgjata të sigurisë kombëtare dhe të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

### TAKIME/TRAJNIME/SEANCA INFORMUESE

